

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 3 i Rregullores së Punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimi i Korrupsionit, duke vepruar për Lëndën e formuar me vetiniciativë, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 83-të të mbajtur më 27 shkurt 2023, miratoi në vijim,

Vendim

Lënda e formuar me vetiniciativë të KSHPK-së për zbatimin e procedurës kundërvajtëse kundër -----, deputet në Kuvendin e RMV-së, NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm të KSHPK-së sipas lëndës me numër 08-9511/1 të datës 13.12.2019.

Lënda me numër 08-9511/1 të datës 13.12.2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetimin në formë të depersonalizuar të publikohet në veb faqen e KSHPK-së në afat kohor prej 5 (pes) ditëve nga dita e miratimit.

Arsyetim

Lënda me numër 08-9511/1 datë 13.12.2022 është formuar me iniciativë të saj.

Pas kontrollit të bazave të të dhënave që disponon Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, u konstatua se personi -----, gjatë zgjedhjes për deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka dorëzuar fletë anketuese në KSHPK. Nisur nga sa më sipër, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitiv.

KOMISIONI SHTETËRORE
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nënkryetar
Katica Nikolovska